

INSTITUCIONI I BESËS DHE I FJALËS SË DHËNË NË EPOSIN SHQIPTAR

Dr. ELVIS BRAMO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
elvisbramo@yahoo.com

ABSTRACT

Regarding the Albanian epic, collected and published for the first time by the Franciscan fathers Bernardin Palaj and Donat Kurti, in 1937, in volume II of the “Visaret e Kombit” (National Treasures) series, with the subtitle “Kânga kreshnikës and Legend” (Kreshnik^[1] Songs and Legends), there were and are opinions of different as to its originality: it is obliquely borrowed, with all the epic content, or our authenticity inherited over the centuries. Without dealing with this historical and ethnological argument, we say that the Epic has, for a long time, accompanied the heroic songs of the Northern Highlands and there are indicators of Albanian virtues, among which Faith and the Word given, are the foundation of the events described and in the actions of the characters. The wise and indefatigable collectors, Palaj and Kurti, *have convincingly expressed that the old songs, known by the Alpine people under the name “Kreshnik songs”, old songs, lute songs, are the most precious treasures of the language, the most vivid expression of many generous feelings and the typical appearance of the physiognomy of our nation.*

Precisely, we are drawn from this depiction, and we have chosen to research within the Epos this characteristic of our people in the regulation of the internal life of the inhabitants, as well as in the relations with other peoples, with whom there have economic, linguistic and psychological relations. In all the content of the brave deeds of Jutbina^[2], Besa was a sacred

^[1] Legendary beings in Albanian Folklore

^[2] Capital of the kreshniks, according to Albanian Epos (at present, a location in Bosnia and Herzegovina)

institution, intact, that distinguished them, compared to border kingdoms and kings, just as the Word given - based on the sanctified Besa - was known throughout the Balkan space and Wider. Muji and Halili, all Kreshniks, were united in faith with each other, at the same time, in deeds and fights with foreigners, in every situation they bound the Faith and the Word of Man and came out victorious. This gift of theirs was recognized and appreciated even by the many enemies, who wanted to occupy their pastures and natural resources.

Keywords: faith, sacred institution, authenticity, heritage, old songs.

1. Në botën e legjendave dhe baladave shqiptare, që janë trashëguar ndër breza, është edhe balada për vëllanë e vdekur. Studiuesi ynë i mirënjohur i pasurisë shpirtërore të popullit tonë dhe hulumtues i etnokulturës shqiptare, Sh. Sinani, shkruan se balada e Kostandinit dhe e Doruntinës, është trajtuar si (krye)vepër që ngre lart kultin e besës, shenjtërinë e fjalës së dhënë...” Ky ¹ motiv i rëndësishëm ka të bëjë me rastin e martesës së motrës shumë larg. Në Shqipëri kjo legjendë njihet me emrin *Halil Garria* ose *Kënga e Dhoqinës*. Ndryshe, diku, del edhe me titullin “Besa e Kostandinit”. Pas një fatkeqësie, që ngjet në shtëpi, i vëllai duke dëgjuar zërin e nënës që i kërkon premtimin se do t’i sillte vajzën kur ta kërkonte ajo, ngrihet nga varri dhe shkon e ia sjell. Në këtë legjendë tregohet edhe se sa peshë ka *Fjala e dhënë*, mendim që e shpreh edhe Prof. Shaban Sinani: “Mesazhi i besës është i pranishëm në frymën e baladës...”²

Kënga e Dhoqinës është një variant i këngës së dëgjuar të arbëreshëve të Italisë: Doruntina ose Garentina. Tek arbëreshët, Doruntina ka dymbëdhjetë vëllezër. Këta vriten në luftë. Te Dhoqina, nëntë vëllezërit helmohen nga një përbindësh. Po në të gjitha balladat, në fund, vdesin nënë e bijë. Të *Bleta Shqiptare* e Thimi Mitkos, kjo legjendë na vjen në prozë (Plaka me nëntë djemtë). Po në këtë motiv, është bazuar edhe Kadare për novelën mjaft të bukur “Kush e solli Doruntinën”.³

¹ Shaban Sinani 2012, *Tradita gojore si etnotekst- Studime për etno-folkloristikë krahasimtare*, Naimi, Tiranë, f. 29.

² Shaban Sinani 2006, *Mitologji në Eposin e Kreshnikëve*, Argeta-LMG, Tiranë, f. 69.

³ Ismail Kadare, *Vepra10: “Ura me treharqe”, “Kush e solli Doruntinën”, “Brezitë e hankonakëve”*.

Në shumicën e baladave për Kostandinin dhe Dhoqinën, kur ndodh vdekja e nëntë vëllezërve, paraqesin nënën, që e vrarë në shpirt për humbjen e djemve, kujton premtimin e Kostandinit, që ta marrë vajzën në gjini për kobin e rëndë; më dendur jepet thirrja dhe një varg pasues nëme, si:

“Kostandin, të ardhtë gjëma,
Martove Dhoqinën larg” ...

Por kemi gjetur edhe me pyetjen “Ku e ke besën, Kostandin!?! Kjo shpjegohet jo aq me vërtetësinë e një britme të nënës, sa me barazimin që populli ynë bën midis konceptit të *Fjalës së dhënë* dhe *Besës*, për një veprim që duhet plotësuar patjetër. Pa u zgjeruar këtu për periudhën e formimit të baladave, shënojmë se stidiuesi i epit shqiptar, përmendur më lart, ka shkruar se *bashkë me eposin, deri në kohën e kontakteve të para me rrezikun e ri që po shfaqej nga Orienti, shqiptarët kishin krijuar gjithashtu fondin e baladave, të cilat vinin si kujtime tronditëse të epokave të shkuara. Njëra prej tyre është ajo që njihet në jug me emrin e Kostandinit dhe Doruntinës, kurse në veri me emrin “Kanga e Halil Garrisë”. Kjo baladë mbajti gjallë në kohëra hermetike shpresën mahnitëse të kthimit të njeriut tokësor prej botës së vdekjes.*⁴

2. Së dyti, edhe balada legjendare e ngritjes së kështjellës së Shkodrës,⁵ ka në qendër *besën* e tre vëllezëve, madje *besën e thyer*, kur fjalën e dhënë e mban vetëm vëllai i vogël: nuk i thotë vashës Rozafë të mos sillte bukë të nesërmën, ndërsa dy më të mëdhenjtë u tregojnë vashave të tyre; ja si e përcjell balada këshillën e plakut dhe reagimin e vëllezërve:

- Puna e mbarë, o ju tre vëllazën !
- Ku po e shef ti t’mbarën tonë ?
Gjithë ditën po punojmë
E gjithë natën po na rrënohet
- A din gja plak me na diftue ?
Kjo kala që nuk shtërngon ?

⁴ Shaban Sinani 2006, *Mitologji nëEposin e Kreshnikëve*, Argeta-LMG, Tiranë, f. 68-69.

⁵ Studiuesit pohojnë se legjendat apo baladat e murosjes shtrihen në të gjithë Ballkanin dhe Europën.

.....
 - Unë e di por kam gjynah.
 - Atë gjynah ti lena ne !
 Kish qitë plaku e u kish thanë
 - A jeni të tre të martuem
 A i kini të tre vashat ?
 Po, na të tre të martuem jena
 E të tre vashat i kena.
 Na difto pra çka me ba ?
 -Pa ndigjoni ju tre vëllazën
 Për n'e daçi ndrejt me punue
 Porosinë që po ju jap
 Kujt mos shkoni me i diftu.

.....
 Lidhni besë e lidhni fe.

.....
 Në konak mos bisedoni
 Vashave mos iu kallxoni
 Nesër nade porsa të zbardhin
 Cila vashë që ju bijnë bukën
 Atë murojeni në kala.

.....
 Se vojt ma i madhi vëlla
 Çarti besë e çarti fe
 Në konak e bisedoi
 Vashës së vet ky i kallxoi.
 Ashtu i dyti vëlla
 Harroi këshillin që pat vu
 Atë që plaku i pat diftue
 Çarti besë e çarti fe
 Në konak e bisedoi
 Vashës së vet edhe ky i diftoi

.
 Heu ! Ma i vogli vëlla
 Mbajti besë e mbajti fe
 Në konak s'e bisedoi
 Vashës së vet nuk i kallxoi.....

Në katër vargje përsëritet emri “besë”: njëherë me foljen në urdhërore “lidhni besë” dhe tri herë me folje në të kryerën e thjeshtë “çarti besë” e, në të gjitha rastet, këto folje dalin brenda vargjeve, duke përsëritur SV (folje + emër): *çarti fe*.

Nocioni i besës, në këtë baladë lidhet me epokën kristiane, kur ai vjen e bashkëshoqërohet edhe me fenë, besimin, më tej edhe aludon me apostullin Judë, që preu në besë Jezusin, duke e kallëzuar tek romakët.... Akti i flijimit që vihet në qendër të baladës së Rozafës, lidhet sigurisht, me kohën e themelimit të *qyteteve të mëdha prehistorike, kështjellave dhe urave të lashta*. “Flijimi, sipas Sh.Sinanit, gjendet edhe te grekët e vjetër, për mbarësi të fushatave luftarake (miti i Efigjenisë), *tek hebrejtë në formën e dëshmimit të devocionit ndaj Perëndisë (Abrahami) dhe tek popuj të tjerë*.”⁶

3. Së treti, duke e ndjekur këtë argument në mënyrë kronologjike,⁷ shohim se edhe në librin e parë juridik “Kanunin e Lekë Dukagjinit”,⁸ mbledhur prej Atë Shtjefën Gjeçovit, zë vend trajtimi i *besës libri i tetët, Ndera, f. 63, f. 66, f. 68*, ku nenet e këtij kodi drejtësie popullore shtjellojnë rastet kur “pritet miku në besë”, prej të pabesit, për të cilin thuhet në & 648: “*I pabesi, qi pret kend vetë a shet kend në besë, grihet⁹ katundisht¹⁰ e shkon gjakhupës*.”¹¹ Në kanun, termi *besë-a*, merr edhe një kuptim tjetër, shënuar në disa paragrafë si: parag. 854 e vijim, në ff. 81-87...Ja dhe shpjegimi i II i termit: “*Besa asht një vade liri e sigurimi, qi shpija e të vramit i jep dorërasit e shpijarëvet të tij, tuj mos e ndjekë për gjak përkohsisht e mje në vade të caktueme*.”¹²

Në letërsinë tonë, ka shembuj ku me anë të virtytit të *besës*, vijnë e dallohen shqiptarë e shkje, siç del në poemën e madhe “Lahuta e Malcis” e Gj.Fishtes (“*Shkjau besë nuk ka*”).

⁶ Shaban Sinani 2006, *Mitologji në Eposin e Kreshnikëve*, Argeta-LMG, Tiranë, f. 70.

⁷ Për personalitetin e princit Lekë, i cili merret si autor i Kanunit, shih: Tonin Çobani, “Princi i përfulur Lekë

Dukagjini”, Toena, Tiranë, 2003, f. 3. Autori trajton edhe ngjarjen historike “WBesëlidhja e Lezhës”.

⁸ At Shtjefën Gjeçovi 2010, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Botime Françeskane, Shkodër,

⁹ grihet – këtu: vritet, pushkatohet prej gjithë fshatit.

¹⁰ katundisht – fshatçe.

¹¹ Po aty, f. 68.

¹² Po aty, f. 83.

Argumenti

Në nisje të këtij argumenti të zgjedhur prej nesh, është me vend të njihemi me semantikën dhe bazën për pasoja fjalëformuese të lemës *besë-a*, sipas Fjalorit të gjuhës shqipe.¹³ Në fjalor, shpjegimi del si vijon: “ *besë/-a* f.1. fjala e dhënë me sigurinë se do të mbahet, fjala e nderit për një zotim: *i doli nga besa; për besë!* për fjalë të nderit; me të vërtetë; *besa e burrit – pesha e gurit* (fj.u.); vazhdohet me 4 shpjegime, përfshirë shprehje dhe frazema, për të kaluar tek formimet me përngjitje, ndajshesa si dhe kompozita; janë 31 fjalë të reja, fjalë aktive në përdorimin e standardit të sotëm të shqipes, ashtu edhe në letërsinë artistike.

Që në këngën e parë “Gjeto Basho Muji”,¹⁴ del *besa* që lidhet mes heroit kryesor të Eposit dhe Zanave “*Besa besë e fjala fjalë!*”¹⁵; *besë* lidh edhe Halili me të bijën e kajlit, Tanushën (kanga IV- e ëma besëthyer ndaj së bijës), ashtu si nallban-probatini tek kënga V (Gj.Elez Alija); si Dizdar Osman Aga, që mendon të ndahet prej Mujit (se po u merr të gjitha lavdet!). Në Epos, *besa* shkon krah për krah me *pabesinë*: nëna e Zukut Bajraktarit shtie dashuri me Balozin e huaj, verbon të birin dhe e torturon, deri sa ky arrin të lidhet me Orët, të cilat i janë *besnike*, e u çlirojnë dhe atyre djalin, *Besën e Zotit orëve jau ka dhanë/Se ‘i nam t’zi n’nânen due me bâ.../ Be në Zotin Zuku ka bâ.*¹⁶

Pa u zgjatur me shembujt e *besës* e të *pabesisë* në Këngët e Kreshnikëve (Eposin heroik), do të ndalemi tek kënga XIII, e cila mban titullin “Ali Bajraktari” dhe nën të, mbledhësit françeskanë kanë shkruar me të madhe emrin “B E S A “. Fabula është kjo: *Ali Bajraktari merr bekimin dhe besën e nënës se nuk do t’ia hapte kujt derën përveç atij, del me u njohë me far e fis e miqtë e babës. Tue kalue nëpër bjeshkë, ulet të pushojë pranë një gurre, e merr gjumi dhe, sa e heton krajli i Çesadës, e burgos; mandej i shkruan nuses së tij të martohej se Alija do të kalbej në burg. E shoqja i shkruan letra tri vjet rresht, njëra i bie në dotë Aliut dhe fshan, kërkon leje për 6 ditë, tue i dhanë besën e Zotit se do të kthehej, por krajli nuk*

¹³ AShSh2020, Fjalor i Gjuhës shqipe, Tiranë.

¹⁴ Visaret e Kombit-Kangë kreshnikësh dhe Legjenda, mbledhë dhe redaktue nga At B.Palaj dhe At D.Kurtit, Botime Françeskane, Shkodër, 2007, f. 1-10.

¹⁵ Po aty, f. 9/10.

¹⁶ Po aty, f. 93.

i jep, vetëm kur hyn dorëzanë e bija. Shkon Aliu në Jutbinë dhe gjen dasëm në shtëpi të tij. Askush nuk po e njeh. Takon shokë e miq, takon Mujin e Halilin, të cilëve u thotë se Alija kishte vdekë në burg dhe, bash ai, e kishte varrosë. I shfaqet vetëm nuses dhe ikën me të, por kujton besën e dhënë e kthehet tek krajli, i cili e çmon për besnikëri dhe e fal se i doli me të vërtetë burrë bese! Kumti i besës zë fill me betimin e nënës, e cila “Besën e Zotit nana ia ka dhanë/Që kurrkuj derën nuk ia çili/ Për pa ardhë Alija, em bir.” Edhe kur del haptas dhe i bëjnë dasmën, Aliu kujton besën e krajlit dhe i thotë nuses:

Prap n’krajli m’duhet me dalë,
Pse besën e Zotit krajlit ia kam dhanë,
Sot gjashtë dit aty prep me kanë,
Aspak besë krajli s’më ka xanë...¹⁷

Këtu besën e mban shqiptari, por veprimin e respekton vetë krajli, i cili:

Ka qitë Alis e i ka thanë:
-Hajt, Ali, t’kjoftë rruga e mbarë!
Se besnik ti kenke kânë -
E në shpi Alija prep ka dalë. ¹⁸

Kreshnikët e Jutbinës, edhe pse kishin besë me Zanat e malit, nuk i thërrisnin orë e çast ato për ndihmë. Por në këngën 31 “Deka e Halilit” (f. 227), kur Muja del për hakmarrje për vëlla Halilin, bëj bejlek me Bani Zadranin, i cili, në duel fizik me të, përgjatë tri ditëve e tri netëve, arrin ta rrëzojë dhe është gati ta vrasë. Trimi kujtohet t’u thërrasë Zanave besnike, megjithëse sentenca latine thotë “*Inter arma silent muse*”¹⁹:

“Ju ku jeni të Lumet e natës,
Qi probatesha juve u ko’ pa’ xanë,
Gjith tu të bij mâ ngusht e mâ

¹⁷ Po aty, f. 116.

¹⁸ Po aty, f. 117.

¹⁹ *Inter arma silent muse (lat.)* midis armëve, heshtin muzat.

Edhe ndimë kini me m'dhanë,
Se Zadrani shpirtin po ma merr?"²⁰

Veis Sejko, në librin e tij kushtuar Eposit shqiptar dhe marrëdhënieve me këngët kreshnike të Bosnjës dhe Hercegovinës,²¹ na jep të dhëna se termi "besë-a" në gjuhën shqipe, hyn në përbërje edhe të mallkimeve të ndryshme, kryesisht për besëthyerit, siç tregon ai për ngjarjen kur Ajkuna kthehet në shtëpi, e torturon i ati dhe, kur kalon pranë saj, Vuk Harambashi i thotë me mëllëf:

"T'u nxiftë besa, Ajkunë e mirë,
Përgjithmonë besën ti ma ke dhanë
E hala një sahat nuk asht ba,
Ke çue shqiptarët e m'kanë zanë."²²

Tregues i vërtetë i besës dhe i bashkimit, në Eposin tonë kombëtar, më së pari është dalja unike e trimave në çetë, aq sa, në shumë variante, gjenden vargje ku tregohet se *besa* i lidh në bëmat e tyre. Me anë të besës, në Epos, shfaqet *vetëdija e bashkësisë*, dallimi prej të tjerëve që nuk janë *çetanikë*. Kur lexojmë Eposin na del para syve ndjenja e vendbanimit, kufijtë, bjeshkët, kullotat si pronë dhe bazë ekonomie, si atdhe shpirtëror, edhe pse i megjulluar në psikikën e shqiptarit.

Përfundime

1. Yni apo i huazuar pjesërisht apo edhe tërësisht – si përkthim – Këngët e Kreshnikëve, përndryshe Eposi kombëtar, ka shoqëruar në shekuj identitetin e të parëve tanë, duke na dallaur edhe prej popujve të tjerë që na rrethojnë.²³

²⁰ Visaret e Kombit 2007, Kangë kreshnikësh dhe Legjenda, mbledhë dhe redaktue nga At B. Palaj dhe At

D. Kurtit, Botime Françeskane, Shkodër, f. 229.

²¹ Veis Sejko 2002, Elementet e përbashkëta në Epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate, Bargjini, Tiranë.

²² Po ai, po aty, f. 51.

²³ Veis Sejko 2002, Elementet e përbashkëta në Epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate,

2. Gjuha e këngëve tona epike, ka pësuar ndryshime përgjatë kohëve, aty gjen huazimet dhe zhvillime sipas natyrës së shqipes, nga leksiku, fjalëformimi dhe sintaksa e saj.
3. Besa, në krijimet tona folklorike, përndryshe, të pasurisë shpirtërore të shqiptarëve, na shfaqet si veti, cilësi dhe virtyt, para të cilit janë përkulur me nderim breza të tërë, që e kanë njohur atë si institucion më vete.
4. Përveç besës, përkrah saj, në popullin tonë është përfshirë edhe *fjala e dhënë*, si shenjtëri e individit shqiptar apo qysh prej kohëve iliriane.
5. Ndonëse virtyti i besës edhe i betimit, mund të marrë kuptimin e njeriut të nënshtruar, të varur, njeriut që ka nevojë ta përdorë institucionin e besës e të betimit, prapëseprapë, kjo del si një cilësi e lartë e sjelljes dhe komportimit në faza të ndryshme të historisë sonë kombëtare.

BIBLIOGRAFIA

ASHSH 2020, Fjalor i Gjuhës shqipe, Tiranë.

GJEÇOVI AT SH. 2010, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Botime Françeskane, Shkodër.

KADARE I., Vepra 10: “*Ura me tre harqe*”, “*Kush e sollti Doruntinën*”, “*Breznitë e hankonakëve*”.

SINANI SH. 2012, *Tradita gojore si etnotekst- Studime për etno-folkloristikë krahasimtare*, Naimi, Tiranë.

SINANI SH. 2006, *Mitologji në Eposin e Kreshnikëve*, Argeta-LMG, Tiranë.

SEJKOV., 2002 *Elementet e përbashkëta në Epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate*, Bargjini, Tiranë.

Visaret e Kombit 2007, *Këngë kreshnikësh dhe Legjenda*, mbledhë dhe redaktue nga At B.Palaj dhe At D.Kurtit, Botime Françeskane, Shkodër.

Bargjini, Tiranë, f. 13. Shkruan Sejko: “Shkrimtari i shquar frëng Prosper merime...arrit në një përfundim të pavlerë dhe aq të pavlerë sa bëri një deklaratë: “*Si është e mundur që një popull midis grekëve dhe serbëve të ketë qëndruar kaq ngurtësisht i huaj në lëvizjen poetike të tyre*”.